

VENDIM
Nr. 387, datë 6.5.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR KONTROLLIN E ASGJËSIMIT TË PCB-ve,
ÇNDOTJEN APO ASGJËSIMIN E PAJISJEVE QË PËRMBAJNË PCB DHE/OSE
ASGJËSIMIN E MBETJEVE TË PCB-ve TË PËRDORURA¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim të rregullojë asgjësimin e kontrolluar të PCB-ve, çndotjen ose asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e PCB-ve të përdorura, në mënyrë që ato të eliminohen plotësisht.

2. Për qëllime të këtij vendimi, të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim, ndërsa termat e mposhtëm nënkuptojnë:

“Asgjësim i PCB-ve”, një prej operacioneve D 8, D 9, D 10, D 12 e D 15, të asgjësimit, të cilit u nënshtrohen pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, që nuk mund të çndoten (vetëm në magazinimin nëntokësor të sigurt dhe të thellë, në formacione shkëmbore të thata).

“Çndotje/rikthim në gjendjen para ndotjes”, çdo veprim, përfshirë zëvendësimin me lëngje të përshtatshme, që nuk përmbajnë PCB, i cili mundëson, më pas, ripërdorimin ose riciklimin e pajisjeve.

“Pajisje që përmbajnë PCB”, çdo pajisje që përmban PCB ose që ka pasur përmbajtje të PCB-ve (p.sh.: transformator, kondensator, kontejner të mbeturinave stoqe, të cilët nuk janë çndotur).

“Zotërues”, personi fizik/juridik, publik ose privat, që zotëron pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe/ose PCB të përdorura brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

KREU II
**DETYRAT E ZOTËRUESVE TË PAJISJEVE, OBJEKTEVE, MATERIALEVE DHE
LËNGJEVE QË PËRMBAJNË PCB DHE PCB TË PËRDORURA**

1. Pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të eliminohen brenda vitit 2018.

2. Për përmbushjen e afatit të përcaktuar në pikën 1, më lart, zotëruesit e pajisjeve, objekteve, materialeve dhe lëngjeve që përmbajnë PCB, duhet të marrin masa:

a) të çndotin këto pajisje nga PCB-të, në mënyrë që të mund të ripërdoren apo riciklohen;

b) të asgjësojnë, me një prej operacioneve të asgjësimit, të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB që nuk mund të çndoten dhe PCB-të e përdorura.

3. Operacionet D 8, D 9, D 10, D 12 e D 15, të asgjësimit, përcaktohen në shtojcën 1 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

4. Çndotja apo asgjësimi kryhet nga persona fizikë/juridikë, të pajisur me leje mjedisi, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencën III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

5. Çndotja apo asgjësimi është përgjegjësi e zotëruesit, i cili kontraktton person fizik/juridik të licencuar, sipas pikës 4 më lart, ose i eksporton, sipas legjislacionit në fuqi për mbetjet. Kur për asgjësim përdoret metoda e incinerimit, atëherë zbatohen kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 178, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për incinerimin e mbetjeve”.

¹ Ky vendim transponon plotësisht direktivën 96/59/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 16 shtator 1996, në lidhje me asgjësimin e bifenileve të poliklorinuar dhe trifenileve të poliklorinuar (PCB/PCT) (GZ L 243, 24.9.1996, f. 0031-0035), e amenduar nga rregullorja 596/2009/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 18 qershor 2009 (GZ 188, f. 14, datë 18.7.2009) EUR-Lex – 31996L0059.

6. PCB-të e përdorura dhe pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB, përpara se të dorëzohen për t'u çndotur apo për t'u asgjësuar, mbahen larg çdo produkti të djegshëm/të ndezshëm, për të shmangur çdo rrezik zjarri.

7. Nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri në fund të vitit 2018, zotëruesit e transformatorëve që përmbajnë PCB mund t'i përdorin ata:

a) vetëm nëse PCB-të që përmbajnë përputhen me standardet teknike ose specififikimet që lidhen me cilësinë dielektrike/jopërçuese;

b) nëse janë në gjendje të mirë pune dhe nuk kanë rrjedhje.

8. Transformatorët që përmbajnë më shumë se 0,05%, në peshë, të PCB-ve, çndoten sipas kushteve të mëposhtme:

a) duke reduktuar nivelin e PCB-ve nga 0,05% deri 0,005%, të peshës;

b) duke bërë zëvendësimin me një lëng që nuk përmban PCB, i cili sjell, në mënyrë të dukshme, më pak rreziqe;

c) zëvendësimi i lëngut nuk përjashton detyrimin e zotëruesit për asgjësimin, më pas, të PCB-ve;

ç) etiketimi i transformatorit pas çndotjes zëvendësohet me etiketimin e specifikuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

9. Transformatorët, lëngjet e të cilëve përmbajnë nivelin e PCB-ve midis vlerave 0,05% dhe 0,005%, të peshës, çndoten sipas kushteve të përcaktuara në shkronjat "b" deri në "ç", të pikës 8, ose asgjësohen në fund të jetës së tyre.

10. Ndalohet:

a) ndarja e PCB-ve nga substanca të tjera, me qëllim ripërdorimin e tyre;

b) mbushja e transformatorëve me PCB mbi nivelin 0.05%, të peshës;

c) incinerimi i PCB-ve dhe/ose PCB-ve të përdorura në anije.

KREU III

INVENTARIZIMI, RAPORTIMI DHE INSPEKTIMI

1. Raportimi bëhet për pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet me vëllim PCB-je mbi 5 dm³. Në rastin e kondensatorëve të energjisë, të ndërtuar me elemente të veçanta, si një set i kombinuar, pragu prej 5 dm³ përllogaritet në total.

2. Zotëruesit e pajisjeve, objekteve, materialeve dhe lëngjeve që përmbajnë PCB në vëllim, sipas përcaktimit në pikën 1 më lart, dërgojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) vetëdeklarimin paraprak, i cili duhet të përmbajë informacionin, si më poshtë vijon:

a) emrin dhe adresën e zotëruesit;

b) vendndodhjen dhe përshkrimin e pajisjes;

c) sasinë e PCB-ve që përmban pajisja;

ç) datat dhe llojet e trajtimeve ose zëvendësimet e kryera dhe/ose të parashikuara për t'u kryer;

d) PCB-të e përdorura, nëse i zotëron;

dh) datën e vetëdeklarimit dhe nënshkrimin e zotëruesit.

3. Zotëruesit duhet të dorëzojnë vetë-deklarimin paraprak brenda datës 30 qershor 2016.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton inventarin paraprak për pasqyrimin e situatës aktuale të pajisjeve që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, bazuar në vetëdeklarimet e zotëruesve të tyre, brenda vitit 2016. Inventari përmban informacionin e përcaktuar në shkronjat "a" deri në "dh", të pikës 2 më lart.

5. Pas afatit të përcaktuar në pikën 3 më lart, deri në vitin 2018, pas përfundimit të afatit për çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB apo PCB të përdorura, sipas kushteve dhe kritereve të kreut II, të këtij vendimi, zotëruesit duhet të dorëzojnë vetëdeklarimin përfundimtar brenda muajit mars 2019, me këtë informacion:

a) emrin dhe adresën e zotëruesit;

b) vendndodhjen dhe përshkrimin e pajisjes;

c) sasinë e PCB-ve që përmban pajisja;

ç) datat dhe llojet e trajtimeve ose zëvendësimet e kryera;

d) kopje të dokumentacionit që provon se trajtimi apo zëvendësimi është kryer në përputhje me kriteret e përcaktuara në kreun II të këtij vendimi;

dh) PCB-të e përdorura, nëse i zotëron;

e) datën e vetëdeklarimit dhe nënshkrimin e zotëruesit.

Inventari përditësohet brenda datës 15 janar të çdo viti.

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton inventarin përfundimtar për pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, bazuar në vetëdeklarimet përfundimtare të zotëruesve të tyre, brenda vitit 2019. Inventari përmban:

- a) emrin dhe adresën e zotëruesit;
- b) vendndodhjen dhe përshkrimin e pajisjes;
- c) sasinë e PCB-ve që përmbahet në pajisje;
- ç) datat dhe llojet e trajtimeve ose zëvendësimet e kryera;
- d) PCB-të e përdorura;
- dh) datën e vetëdeklarimeve dhe nënshkrimin e zotëruesit.

7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit i dërgon:

- a) kopje të vetëdeklarimeve paraprake, ISHMP-së, brenda datës 31 mars 2017;
- b) kopje të vetëdeklarimeve përfundimtare, ISHMP-së, brenda datës 30 qershor 2019.

8. Për monitorimin e procesit, ISHMP-ja:

a) në bazë të vetëdeklarimeve paraprake, inspekton subjektet deklaruese në lidhje me emrin, adresën e zotëruesit, vendndodhjen dhe përshkrimin e pajisjeve, sasinë e PCB-ve që përmbajnë pajisjet dhe/ose PCB-të e përdorura;

b) në bazë të vetëdeklarimeve përfundimtare dhe rezultateve të monitorimit, të kryera nga AKM-ja, sipas pikës 9 të këtij kreu, inspekton subjektet deklaruese në lidhje me emrin dhe adresën e zotëruesit, vendndodhjen dhe përshkrimin e pajisjeve, sasinë e PCB-ve që përmbajnë pajisjet, dhe/ose PCB-të e përdorura, si dhe llojet e trajtimeve ose zëvendësimet e kryera.

9. Për monitorimin e ecurisë së procesit të asgjësimit dhe/ose çndotjes së pajisjeve që përmbajnë PCB e PCB të përdorura, sipas procedurave dhe detyrimeve të këtij vendimi, AKM-ja merr mostrat dhe kryen analizat laboratorike përkatëse.

10. Çdo pajisje, objekt, material dhe lëng që përmban PCB, etiketohet sipas etiketës së vendosur në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi. Etiketa vendoset, gjithashtu, në dyert e godinës ku ndodhen pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB apo ku ndodhen PCB-të e përdorura.

11. Personi fizik/juridik, që është i licencuar sipas pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi, dhe që asgjëson/çndot pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB apo PCB të përdorura, mban regjistër ku pasqyrohet të dhëna për sasinë, origjinën, natyrën dhe përmbajtjen e PCB-ve që i janë dorëzuar dhe procesin e asgjësimit/çndotjes, të cilit ato i janë nënshtruar. Personi fizik/juridik i dërgon informacion AKM-së, brenda 30 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të pajisjeve, objekteve, materialeve dhe lëngjeve që përmbajnë PCB apo PCB të përdorura. Format i regjistrit dhe të dhënat që do të përmbajë ai miratohen me urdhër të ministrit.

12. Lista e emrave të prodhuesve të kondensatorëve, rezistencave dhe bobinave me induktim/përcjellshmëri, që përmbajnë PCB, miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Mjedisit dhe ministrit përgjegjës për energjinë.

13. Mospërmbushja e kërkesave të këtij vendimi përbën kundërvajtje administrative, sipas pikës 26, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

14. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCË 1

ETIKETIMI I PAJISJEVE PCB TË DEZINFEKTUARA

Çdo njësi e pajisjes së dezinfektuar duhet të shënohet qartë me një shenjë të përhershme (që nuk hiqet) dhe e gdhendur ose e stampuar, e cila duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm dhe të shkruhet në gjuhën e vendit në të cilin përdoret pajisja:

PAJISJE PCB E DEZINFEKTUAR

Lëngu që përmbante PCB është zëvendësuar

- me (emri i zëvendësuesit)
- më (data)
- nga (sipërmarrësi)

Përqëndrimi i PCB-ve në

- lëngun e vjetër % në peshë
- lëngun i ri % në peshë.

SHTOJCË 2



